



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:023961
Datë: 17.09.2024
Numri i dokumentit: 06168539

C.nr.464/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, gjyqtarja Njomëza Berisha, në çështjen juridiko-kontestimore të paditëses L.T. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av.B.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve „Sigma“, me seli në Prishtinë, rruga „Pashko Vasa“, nr.13, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur jashtë seancës, me datë 17.09.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr padia e paditëses L.T. nga Prizreni kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigma”, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit.

A r s y e t i m

Pranë kësaj gjykate paditësja L.T. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj, av.B.M. nga Prizreni, ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigma”, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit.

Me datë 09.09.2024, i autorizuari i apditëses, av.B.M. me anë të parashtrësë drejtohet gjykatës, përmes të cilës ka bërë tërheqjen e padisë sepse palët ndërgjyqëse kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore në mes vete.

Neni 261 par.1 i LPK-së parasheh: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi.”*

Në këtë drejtim, duke marrë parasysh bazën ligjore të lartëcituat, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për të konstatuar të tërhequr padinë e paditëses L.T. të ushtruar kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigma”, me seli në Prishtinë, e duke bazuar në nenin 261 pika 1 të LPK-së, pasi që në rastin konkret i padituri deri në këtë fazë të procedurës, në gjykatë nuk ka paraqitur përgjigje në padinë e paditëses.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2022:023961
Datë: 17.09.2024
Numri i dokumentit: 06168539

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPRATAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.464/2022, dt.17.09.2024

Gjyqtarja,
Njomëza Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa, bazuar në nenin 261.4 të LPK-së.